



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 161, datë 31.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË STATUTIT SI PASOJË E NDYSHIMIT TË EMRIT
TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT NGA “SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA”
SH.A. NË “SIGAL LIFE INSURANCE GROUP” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr.9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 12, 57 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 2, të statutit, si pasojë e ndryshimit të emrit të shoqërisë së sigurimit nga “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a., në “SIGAL LIFE Insurance Group” sh.a. me këtë përmbajtje:**

“Neni 2

Emërtimi

- 1. Emërtimi i plotë i shoqërisë do të jetë: “SIGAL LIFE Insurance Group” sh.a. (“Shoqëria”).**
- 2. Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj zyrtare.**
- 3. Në të gjitha aktet e dala nga Shoqëria të destinuara për të tretët do të tregohet emërtimi i Shoqërisë si dhe adresa e selisë së saj.”**

- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**